

KONTRATË SHITJE KUOTASH KAPITALI

TË SHOQËRISË "VASKU" SH.P.K

Sot me date 01.07.2024 ortaket e shoqerise VASKU shpk u mblodhen per te nenshkuar kontraten e shitjes se kuotave ku:

SHITESI:

MIRJAN VASKU, i datelindjes 21.08.1987 pajisur me karten e identitetit I70821054E , zoterues I 1 kuote qe I korrespondojne 49% te kapitalit te shoqerise me vlere 147,000(Njeqind e dyzete e shtate mije) leke.

BLERES:

ERMAL VASKU , i datelindjes 18.01.1999 , pajisur me karten e identitetit J90118032K , zoterues I 1 kuote qe i korrespondojne 100 % te kapitalit te shoqerise me vlere 300,000 (treqind mije e) leke.

Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord te nenshkuajne Kontratën e Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "VASKU" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Neni 1

Marreveshja themelore

Shoqeria VASKU, eshte regjistruar ne QKB me Nipt : M44117802P, me seli: Vlore Sarande Sarande , Rruga Butrinti, zona kadastrale 8642, nr pasurie 24/383, Sarande. 9201, me ortake :

ERMAL VASKU zoteruesi 1 kuote ekuivalente me 51% % te kapitalit me kapital 153,000 leke

MIRJAN VASKU zoteruesi 1 kuote ekuivalente me 49 % te kapitalit me kapital 147,000 leke.

Ne vendimin nr 3 date 01.07.2024. asambleja e ortakeve te shoqerise ka miratuar shitjen e kuotave te zoteruara nga pala shitesse Z. Mirjan Vasku ne favor te pales blerese Z . Ermal Vasku dhe konkretisht:

Pala shitese Mirjan Vasku I shet pales blerese 1 kuote qe perfaqesojne pjesmarrjen ne perqindje 49% te kapitalit te shoqerise” Vasku ” shpk.

Pala blerese Z.Ermal Vasku zoteron 1 kuota qe perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise

Neni 2

Çmimi i Shitjes dhe menyra e likujdimit

Çmimi i plotë i shitjes së kuotave është 147,000 (njeqind e dyzete e shtate mije leke) si me poshte:

Z. Mirjan Vasku ka rene dakort ti shesi pales blerese nëpërmjet shitjes se 1 kuote qe perfaqesojne 49% te kapitalit te shoqerise, kundrejt cmimit 147,000 (Njeqind e dyzete e shtate mije leke) shume e cila eshte likujduar nga pala blerese ne favor te pales shitese.

Pas ketij veprimi, shoqeria do do te kete 1 kuota qe do te zoterohen nga Ermal Vasku

Neni 3

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

Kontratado te regjistrohet ne QKB qysh ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate ndersa kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga Shitësit te Blerësi do të kryhet menjehere.

Neni 4

Garancitë

Shitësi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton Blerësin:

- 1.Se është pronar i kuotave të shitura e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të optionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotate shitura.
- 2.Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotate fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
- 3.Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
- 4.Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas

ditës së lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së Kuotave , veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

5. Pala shitese me nënshkrimin e kesaj kontrate, heq dore perfundimisht nga pronesia mbi kuotatqe shet , te gjitha te drejttat dhe detyrimet i kalojne pales blerese.

Neni 5

Regjistrimi

Regjistrimi i kontrates per kalimin e kuotave nga Shitësit te Blerësi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit do të kryhet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

Neni 6

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikës se Shqipërisë, Ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe përkatësisht dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 7

Dispozitat e fundit

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Kontrata redaktohet ne dy kopje origjinalë konform rregullave dhe ligjeve dhe me vullnet të lirë nënshkruhet nga palët.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITESI

Mirjan Vasku



BLERESI

Ermal Vasku

